



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.9.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
SHTIMES
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtimes, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Mirlinda Beqiri - Udhëheqëse e Ekipit dhe Naim Neziri - Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	19
5 Qeverisja e mirë.....	20
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	23
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	26
Shtojca III: Letër konfirmimi	31

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Shtimes për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 26/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Shtimes.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes dëshirojmë të përmendim faktin se pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000€) të shpalosura në pasqyra si dhe detyrimet kontingjente nuk ishin të sakta.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Shtetes. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Komuna nuk ka shfrytëzuar sistemin e-pasuria për të regjistruar pasuritë jo kapitale të saj, mirëpo regjistrimi i tyre ishte bërë në një regjistër në excel. Vlera e pasurive jo kapitale të shpalosura në PFV ishte 513,000€. Shumica e pasurisë jo kapitale në këtë regjistër ishin të regjistruara pa numër të faturës (dokumentit burimor), si dhe nuk ishte i regjistruar viti përfitimit dhe rrjedhimisht nuk kemi siguri tek llogaritja e zhvlerësimit. Me tutje, shumica e pasurisë jo kapitale janë regjistruar në bazë të vlerës se dhënë nga komisioni i vlerësimit dhe jo sipas kostos historike (faturës se blerjes), si dhe gjendja e stoqeve nuk ishte e saktë. Për shkak të mangësive në këtë regjistër, ne nuk kemi mundur të përcaktojmë nëse zhvlerësimi i llogaritur dhe respektivisht vlera blerëse dhe ajo neto e pasurive e shpalosur në pasqyra është e saktë; dhe
- Komuna nuk ka shpalosur fare detyrime kontingjente, derisa sipas konfirmimit nga avokati i komunës, vetëm për lëndët gjyqësore që komuna posedonin vendime të gjykatës themelore (të cilat janë në procedurë të apelimit) arrijnë vlerën 32,555€.

Opinionin jonë nuk është modifikuar (apo kualifikuar) për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Shtimes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet mujore dhe tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; raportet operative (të performancës);
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve.

PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2018 ishin prezantuar me disa mangësi si në vijim:

- Me kërkesën e thesarit komuna ka ndryshuar Nenin 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, duke zvogëluar vlerën e realizimit e të hyrave, për të hyrat indirekte nga gjobat dhe dënimet e trafikut në vlerë 22,550€; dhe
- Neni 13, Raporti për Llogaritë e Arkëtueshme (LLA), vlera e LLA-ve nga tatimi në pronë është mbivlerësuar për 4,974€.

Me pas komuna ka korrigjuar pasqyrat e saj duke përmirësuar raportimin e saj, për mangësitë e lartcekura.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, pas korrigjimit dhe dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Auditimi ynë ka konfirmuar se komuna ka plotësuar të gjitha kërkesat tjera për raportim më përjashtim të raportimit të rregullt mujor të obligimeve, kërkesë e Rregullës Financiare 02/2013 të MF-së. Pas këshillës tonë në fazën e ndërmjetme të auditimit, nga muaji shtator i vitit 2017, komuna ka filluar rregullisht të raportoj obligimet e papaguara.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksimin e Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në shpalosjen e pasurive dhe detyrimeve kontingjente dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të tyre.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Shtimes kishte treguar një performancë të mirë buxhetore, me realizim të shpenzimeve në 96% të buxhetit final. Po ashtu përmirësime janë vërejtur në disa fusha përfshirë menaxhimin e investimeve kapitale, subvencioneve, si dhe në menaxhimin dhe raportimin e llogarive të arkëtueshme dhe te obligimeve.

Megjithëse edhe me tutje mbeten një numër i konsiderueshëm i fushave në të cilat nevojiten përmirësime. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi nuk janë mjaftueshëm të përshtatshme dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Me tutje kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtijshëm për të parandaluar pa rregullsinë e shpenzimeve dhe keq klasifikimet e mundshme. Në kuadër të shpenzimeve fusha me sfiduese mbetet menaxhimi i personelit.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	6,364,152	6,566,393	6,277,581	6,214,692	5,794,106
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,790,692	5,802,412	5,710,763	5,691,620	5,435,636
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	83,782	81,198	64,256	49,652
Të hyrat vetjake ³	573,460	573,460	379,008	384,134	270,359
Donacionet e brendshme	-	-	-	6,000	-
Donacionet e jashtme	-	106,739	106,612	68,682	38,459

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 190,521€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme në vlerë 106,739€, si dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 83,783€.

Në vitin 2017, Komuna e Shtimes ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 6,277,581€, me një rënie simbolike për 2% krahasuar me vitin paraprak, ku norma e shpenzimit ishte 98%. Shkalla e ngjashme e ekzekutimit të buxhetit ishte edhe viteve të kaluara (97% në vitin 2015).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	6,364,152	6,566,393	6,277,581	6,214,692	5,794,106
Pagat dhe Mëditjet	3,922,416	3,922,416	3,904,629	3,881,699	3,751,002
Mallrat dhe Shërbimet	564,705	582,728	504,902	513,537	410,380
Shërbimet komunale	169,650	169,650	166,621	170,078	162,065
Subvencionet dhe Transferet	113,037	127,046	118,406	161,269	136,692
Investimet Kapitale	1,594,344	1,764,553	1,583,023	1,488,109	1,333,967

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje nuk ka ndryshuar nga buxheti fillestar;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime për 18,023€, si dhe subvencione në vlerë 14,009€ ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i mëparshëm; dhe
- Rritja e buxhetit për investime kapitale në vlerë 170,209€, ishte si rezultat i granteve nga donatorët e në vlerë 106,739€, si dhe të hyrave të bartura në vlerë 63,470€.

Vlen të theksohet se ekzekutimi i buxheti me përjashtim të kategorisë së mallrave, shërbimeve 87% dhe investimeve kapitale 90%, për të gjitha kategoritë tjera është shpenzuar mbi 90%.

Çështja 2 – Klasifikim i shpenzimeve në kategori dhe kode jo adekuate.

E gjetura Pagesa lidhur me kontratën “Furnizimi me pajisje (ndriçim) për shtëpinë e kulturës në Shtime” në vlerë prej 6,905€, ishte buxhetuar dhe realizuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Kjo pagesë për nga natyra e shpenzimit i takon kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Po ashtu, në tri⁴ raste tjera komuna ka regjistruar shpenzimet në kode të gabuara brenda kategorisë së investimeve kapitale në vlerë 34,198€. Si pasojë është

⁴ “Ndërtimi i shkollës fillore në Muzeqinë në komunën e Shtimes”, “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve në fshatin Gjyrkoc” dhe “ Rregullimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në rrugët A. Jashari dhe Komandant Kumanova në Shtime”

mbivlerësuar kodi 31230 – ndërtimi i rrugëve lokale, kundrejt kodeve Ndërtimi i shkollës, rrjetit të kanalizimit dhe trotuareve.

Rreziku Regjistrimi i shpenzimeve në kode të pasakta e rrit rrezikun e prezentimit të sakt të shpenzimeve dhe nuk është në harmoni me rregullat financiare të cilat kërkojnë që fondet të shpenzohen për qëllimet e planifikuara. Poashtu e zvogëlon efektivitetin e menaxhimit të buxhetit.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të buxhetohen dhe realizohen në harmoni me planin kontabël sipas kodeve dhe klasave adekuate të parapara me legjislacionin në fuqi, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Shtimes në vitin 2017 ishin në vlerë 543,288€. Burimi kryesor i këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, etj

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	573,460	573,460	543,288	467,798	334,729
Totali	573,460	573,460	543,288	467,798	334,729

Realizimi i të hyrave arrin normën 95% e buxhetit final. Realizimin e lartë të të hyrave e kanë ndikuar dy transaksione për shpronësimin e tokave në vlerë totale 146,865€. Nëse përjashtohen të hyrat nga shpronësimi (si të hyra jo të zakonshme sepse nuk planifikohen/pranohen çdo vit), norma reale e inkasimit është 69%, që krahasuar me vitin paraprak ka rënie për 23% (viti 2016 norma e inkasimit 92%). Tatimi në pronë si kategori dominuese e të hyrave vetjake ka shënuar rënie krahasuar me vitin e kaluar për 24%.

Çështja 3 – Regjistrimi i të hyrave në kode jo adekuate

E gjetura Komuna nuk kishte kontrolle adekuate në regjistrimin dhe raportimin e të hyrave. Ne identifikuam gabimet si në vijim:

- Të hyrat nga shpronësimi i tokave prej 88,185€ ishin regjistruar gabimisht në kodin ekonomik “taksë për ndërrim destinimi të tokës”; dhe
- Dy fatura në vlerë 111€ ishin regjistruar gabimisht në kodin ekonomik “taksa për leje ndërtimi”, derisa të hyrat i takonin shërbimeve për gjeodezi.

Rreziku Mangësitë e identifikuar rrisin rrezikun e pasqyrimin jo të drejtë të hyrave sipas kodeve ekonomike dhe rezultojnë me shpalosje të pa saktë të tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi 3 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrollit në këtë fushë, që të hyrat të regjistrohen sipas kodeve ekonomike adekuate me qëllim të prezantimit të drejtë në përputhje me planin kontabël dhe natyrës që ato i takojnë.

Çështja 4 – Parregullsi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

E gjetura Komuna nuk kishte arritur të siguroj kontrole të mjaftueshme në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë. Ne identifikuam parregullsitë si:

- Në një rast nuk janë aplikuar normat e duhura tatimore bazuar në kategorinë e pronës, të rregulluar sipas nenit 1, pika 1.2 e rregullores së komunës për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017. Kategoria e pronës ishte vlerësuar si industri/punishte, me norma tatimore 0.18%, derisa rregullorja parasheh normën 0.15%;
- Në një pronë tjetër, kategoria e pronës afarizëm-depo/magazine, është vlerësuar metri katror me 150€ si pronë industriale, në kundërshtim me nenin 3 të rregullores së komunës pika 3.4.3 ku vlera për m² e pronave komerciale është 250€/m. Si pasojë të hyrat ishin nënvlerësuar për 69€;
- Sipas nenit 9, Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, çdo person fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos se prona ose njësia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës. Komuna nuk ka respektuar këtë kërkesë ligjore duke aplikuar këtë zbritje për dy e më shumë prona. Në një rast një tatimpaguesi i janë njohur tetë prona si banim kryesor. Kjo ka rezultuar me një nënvlerësim të te hyrave prej 105€ në vit. Gjendja e njëjtë është aplikuar edhe në nëntë raste tjera ku një tatimpaguesi i janë njohur dy prona si banim kryesor; dhe
- Në 19 raste, tatimpaguesit kanë marrë më shumë se një numër identifikues, për shkak të regjistrimit të dy ose më shumë pronave. Kjo ka vështiruar konfirmimin e zbritjes prej 10,000€ për banim kryesor, si dhe ka rrit në mënyrë fiktive numrin e tatimpaguesve në sistem.

Rreziku Mangësitë e identifikuar ndikojnë në kalkulim jo të saktë dhe të parregullt të ngarkesave për qytetarin. E gjithë kjo ndikon në normën reale të mbledhjes së tatimit në pronë.

Rekomandimi 4 Kryetari i Komunës duhet të rishikojë kontrollet në menaxhimin e të hyrave të tatimit në pronë, duke siguruar së është kontrolluar edhe njëherë lista e tatimpaguesve dhe janë korrigjuar të gjitha gabimet në sistem. Ngarkesat për qytetaret duhet të përcaktohen sipas rregulloreve përkatëse. Në raste të gabimeve tatimet duhet të kalkuloohen në mënyrë retroaktive.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Shpenzimet për vitin ishin 3,904,629€ apo afro 100% e vlerës së buxhetuar.

Rezultatet nga testimet tona janë si me poshtë:

Çështja 5 – Gabime në llogaritjen e pagave për stafin e arsimit

E gjetura Për pozitën “Mësimdhënës në shkollën e mesme profesionale”, provoja e punës nuk ishte kalkuluar saktësisht duke ndikuar në mbivlerësim të pagesës. I punësuari kishte ofruar vërtetimin mbi përvojën e punës për dy vite rresht në dy shkolla, dhe komuna kishte pranuar gabimisht katër vite provojë pune. Gjithashtu për pozitën “Administrator” në shkollën “Lasgush Poradeci Muzeqinë-Shtime” shtesa e kualifikimit ishte 55€, ndërsa komuna kishte paguar sipas listës së pagave 72€, apo 17€ me shumë se vlera e parashikuar në kontratë.

Rreziku Mangësitë e identifikuar mund të rezultojnë me pagesa të parregullta si dhe të ngarkojnë shpenzimet e pagave më shpenzime të paarsyeshme.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të siguroj se janë eliminuar të gjitha gabimet në listat e pagave, në mënyrë që pagesa e pagave të bëhet në përputhje me rregullat në fuqi. Mbi pagesat e bëra gabimisht duhet të korrighohen dhe të ndalen nga pagat në muajt në vijim.

3.4 Menaxhimi i personelit

Burimet njerëzore përbëjnë një nga instrumentet më të rëndësishëm në procesin e administrimit dhe drejtimit të një organizate buxhetore, si të tilla dhe procesi i rekrutimit, administrimit apo drejtimit të tyre, duhet të ngrihet mbi një strategji të hartuar me kujdes. Në kuadër të testimit të dosjeve të personelit dhe proceduarve të rekrutimit në identifikuar mangësitë si:

Çështja 6 – Dobësi në proceset e rekrutimit për stafin e arsimit

E gjetura

Sipas konkursit, për pozitën “Mësimdhënës i mësimit klasor në SHFMU Bajram Curri” dhe “Mësimdhënës i gjeografisë Gjinnazi Naim Frashëri” ne kemi identifikuar dobësitë në zbatimin e proceduarve të rekrutimit si:

- Komuna nuk kishte marrë aprovimin në MF që pozita është e lirë dhe ka mjete të mjaftueshme financiare për financimin e pozitës për “Mësimdhënës në SHFMU Bajram Curri”;
- Kandidatët e përzgjedhur në listën për intervistë, duhet të njoftohen me shkrim, së paku 48 orë para mbajtjes së testeve sipas nenit 5.3 e UA 14/2011 të plotësuar me UA 05/2014. Komuna nuk kishte ofruar dëshmi se kjo procedurë është zbatuar. Sipas zyrtarëve përgjegjës të komunës, komunikimi me kandidatet bëhet vetëm me telefon;
- Intervistat janë realizuar 14 ditë pas testit me shkrim edhe pse rregullat (neni 6.5 e UA14/2011 dhe UA 05/2014) kërkojnë që kjo procedurë të zbatohet brenda 10 ditëve;
- Sipas rregullave kërkohet që institucioni të shpall numrin e pikëve të fituara për secilin kandidatë konkurrues dhe të përzgjedhurin ta informojë në afat prej tri (3) ditëve. Te shkollat e lartpërmendura, rezultatet ishin shpallur vetëm me emrin e të përzgjedhurve, ndërsa tek procesi “Mësimdhënës i mësimit klasor në SHFMU Bajram Curri” i përzgjedhuri është informuar një javë pas intervistave; dhe
- Kandidati i përzgjedhur duhet të nënshkruaj kontratën për themelimin e marrëdhënies së punës në afat prej 15 ditëve (sipas nenit 6. pika 6. e UA 14/2011), prej ditës së informimit të përzgjedhjes së tij/saj nga komisioni intervistues, derisa në rastin e pozitës “Mësimdhënës i gjeografisë në Gjinnazin Naim Frashëri”, kontrata është nënshkruar vetëm një ditë punë pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes, duke mos e respektuar afatin e ankesave.

Dobësitë e identifikuar janë si rezultat i monitorimit jo adekuat të procesit të rekrutimit dhe neglizhencës së komisioneve për respektimin e proceduarve të parapara me rregulla.

- Rreziku** Informatat jo të plota, mos respektimi i afateve kohore dhe kërkesave tjera të përcaktuara rrezikojnë transparencën, konkurrencën dhe parimin e meritës në procesin e rekrutimit të punonjësve të ri.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të siguroje se janë dizajnuar kontrollet e duhura me rastin e rekrutimeve të stafit arsimor nëpërmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shpenzimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalit) në vitin 2017 ishte 752,378€. Prej tyre, ishin shpenzuar 671,523€ apo 89% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet komunale që marrin pjesë me 25%, shërbimet kontraktuese me 23%, mobileje dhe pajisje tjera 18%, derivatet 16%, etj.

Çështja 7 - Mos shqyrtim i deklaratës se nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve

- E gjetura** Sipas nenit 8, pika 8.7. të Udhëzuesit operativ të prokurimit, kërkohet që para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës të bëhet shqyrtimi i deklaratës se nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve (DNPDP) dhe të ri konfirmojnë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht. Në mungesë të kontrolleve adekuate, shqyrtim i DNPDP-së nuk është bërë tek procedura e prokurimit "Furnizim me artikuj ushqimor për Çerdhe, Shtëpinë e komunitetit, dita të shkollave dhe familjeve në nevojë në Komunën e Shtimes".
- Rreziku** Mosrespektimi i kësaj procedure rrit rrezikun që komuna të hyjë në obligime kontraktuale pa siguruar disponueshmërinë reale të fondeve.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të siguroj që është bërë një rishikim i brendshëm për të përcaktuar pse kërkesa e prokurimit mbi shqyrtimin e DNPDP-së nuk është adresuar dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se të gjitha kërkesat nga ligji i prokurimit dhe Udhëzuesi operativ po zbatohen.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Për vitin 2017, buxheti për subvencione dhe transfere ishte 127,046€ dhe deri në fund të vitit komuna kishte shpenzuar 118,406€ apo 93% e buxhetit. Ato kryesisht kanë të bëjnë me fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillim si dhe shëndetësi dhe mirëqenie.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investimet kapitale në vitin 2017 ishte 1,764,553€. Prej tyre, janë shpenzuar 1,583,022€ apo 90% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, trotuareve dhe kanalizimeve që marrin pjesë me 77%, objektet arsimore, shëndetësore dhe sportive me 13%, etj.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna, në PFV-të e vitit 2017 ka prezantuar pasuri kapitale (mbi 1,000) në vlerë prej 45,949,395€ dhe pasurinë jo kapitale (nën 1,000) në vlerë prej 512,845€.

Blerjet kapitale për vitin 2017 janë 1,583,023€, ndërsa pasuria e regjistruar brenda vitit 2017 ishte 2,431,675€, me diferencë 848,652€. Diferenca rrjedh si rezultat i regjistrimit të pagesave të paregjistruara nga viti i kaluar, pranimet nga palët e treta dhe ministritë e linjës, si dhe investimet në vijim të cilat ishin pranuar teknikisht gjatë 2017.

Parregullsitë lidhur me regjistrat e pasurisë jo kapitale janë prezantuar të theksimi i çështjes në opinionin e auditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime tjera në këtë fushë.

3.9 Të arkëtueshmet

Komuna e Shtimes në fillim të vitin 2017 kishte të arkëtueshme në vlerë 458,000€, ndërkaq vlera e kësaj llogarie e prezantuar në fund të vitit është 398,000€. Ulja e vlerës së të arkëtueshmeve është si rezultat i pranimit të të hyrave nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për shpronësimin e tokave komunale. Derisa llogaritë për tatimin në pronë janë rritur gjatë vitit 2017.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në vitin 2017 ishte 106,646€. Obligimet e papaguara, krahasuar me vitin 2016 (185,673€) janë zvogëluar për 79,027€ apo 57%. Pjesa më e madhe e obligimeve (85,526€) të papaguara të prezantuara në PFV për 2017, kanë të bëjnë me obligimet e mbetura për furnizim me ujë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Komunës së Shtimes ka rezultuar me 11 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, katër rekomandime janë zbatuar, tri janë në proces dhe katër nuk janë zbatuar ende.

Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe shtatë rekomandime (një është adresuar, dy të pa zbatuara dhe katër të tjera ishin në zbatim e sipër). Deri në fund të vitit 2017 nga këto rekomandime, dy janë zbatuar, tri kanë mbetur në proces të zbatimit dhe dy të tjera mbesin të pa zbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 8 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura	Mungesa e një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, ka ndikuar që një numër i vogël i rekomandimeve të janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa më e madhe e tyre të mbesin në proces të zbatimit, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet paraprake. Kjo tregon një mungesë të përqendrimit të personave përgjegjës në aplikimin e masave konkrete lidhur me adresimin e këtyre rekomandimeve, që vijnë si rezultat i dobësive të identifikuara në komunë.
Rreziku	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.
Rekomandimi 8	Kryetari duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në qeverisjen lidhur me aktivitetet operationale dhe financiare në komunë, ende mbesin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Përgjigjet efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm, zhvillimi mbi proceset e menaxhimit të rrezikut, si dhe menaxhimi i pasurisë komunale janë disa nga fushat të cilat komuna duhet dhënë prioritet sa i përket një qeverisjeje më efektive.

Komuna e Shtimes posedon Planin Zhvillimor Komunal (2010-2020); Strategjinë për Zhvillim Rural Lokal (2015-2018); Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit Rural (2015-2019); Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal (2014-2018) Plani i Integritetit (2016-2019) si dhe planet operative emergjente.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të auditimit të brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit (KA).

Çështja 9 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve dhe funksionim jo i plotë nga KA

- E gjetura** Nga gjithsej 18 rekomandimet e dhëna, në gjashtë (6) raporte të auditimit, vetëm tetë janë zbatuar, gjashtë janë në proces të zbatimit dhe katër kanë mbetur të pazbatuara. Moszbatimi i rekomandimeve të dhëna tregon një neglizhencë të menaxhmentit për të përfituar nga shërbimet e auditimit të brendshëm dhe sigurisë mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme.
- Gjithashtu bazuar në UA Nr 11/2010 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik, neni 5, kërkon që KA të takohet së paku katër herë brenda vitit. Gjatë vitit 2017, KA në kuadër të komunës kishte realizuar vetëm tri takime.
- Rreziku** Mos funksionimi adekuat i KA rezulton me shqyrtim jo të duhur të raporteve të NjAB. Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve reflekton mungesë të angazhimit nga ana e menaxhmentit (për çështjet e ngritura nga auditimi) për të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësimin dhe funksionimin adekuat të sistemeve financiare dhe të kontrollit.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë që planet e veprimit, të rishikohen, dhe të përcaktohen saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara. KA duhet të mbajë takime të rregullta dhe në procesverbale të nxjerrë konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me çështjet e auditimit të brendshëm.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, në kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Komuna ka arritur ta përpiloj listën e rreziqeve, mirëpo sfidë mbetet strategjia për menaxhimin e rrezikut, si dhe raportimi për menaxhimin e tyre.

Çështja 10 - Dobësi në kontrollet menaxheriale

Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ndonëse ofruan dëshmi që menaxhmenti posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, takimet nuk ishin të formalizuara për të konfirmuar që menaxhmenti i rishqyrton raportet financiare mbi shpenzimet dhe të hyrat dhe operacionet tjera të komunës.

Komuna gjithashtu nuk ka arritur të vendos procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Regjistri i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk përmban një strategji për menaxhimin dhe raportimin e tyre.

Rreziku

Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, komuna duhet të pasurojë regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna ne vitin 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim.	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport, përfshirë rreziqet domethënëse të identifikuar. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.		Komuna ka arritur të përmirësoj raportimin e PFV-ve, megjithëse vlera e shpalosur e pasurive nën 1,000€ nuk ishte e saktë.	
2.3 Rekomandimet e vitit paraparak	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve, që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Kryetari i Komunës në mënyrë sistematike.			Nuk janë marrë masa.
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë që pasi të jetë hartuar regjistri i rreziqeve, është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet.		Regjistri i rreziqeve është hartuar me 22.02.2018 gjatë kohës sa ne ishim në auditim, megjithatë ende nuk arritur të krijojnë një strategji për menaxhimin dhe raportimin e tyre.	

2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të siguroj se ZKF do të raportoj me kohë në lidhje me progresin e arritur për të gjitha projektet kapitale, ashtu siç e parasheh ligji. Raportet e pranimit të mallit të nënshkruhen nga personat e certifikuar.	Po		
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të inicioj plan veprimi sipas sektorëve dhe të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm, ndërsa komiteti i auditimit të bëjë një plan pune ku do t'i specifikoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit. Të mbajë takime të rregullta dhe në procesverbale të nxjerrë konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me çështjet e auditimit të brendshëm dhe të hartoj plan vjetor për menaxhmentin lidhur me përshtatshmërinë e punës dhe burimeve njerëzore të NJAB.		Përkundër faktit se në këtë vit janë ndërmarr aktivitetet shtesë nga menaxhmenti për zbatim të rekomandimeve edhe funksionim të KA, vlerësojmë se kjo fushë ka nevojë ende për përmirësim të mëtejshëm.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurohet që me rastin e planifikimeve buxhetore, të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i burimeve potenciale i të hyrave, dhe të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e inkasimit për vitin 2016.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të sigurojë se para fillimit të një aktiviteti të ri të prokurimit i cili nuk ka qenë i planifikuar ta informoj AQP-në, ashtu siç kërkohet me ligjin e prokurimit.	Po		
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të siguroj vendosjen e një sistemi të kontrollit në këtë fushë, që pagesat të bëhen sipas kategorizimit të ndarjeve buxhetore në përputhje me LMFP dhe planin kontabël.	Po		

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e bashkëfinancimeve në të ardhmen, do të jetë palë aktive dhe e barabartë në përcjelljen, realizimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve. Praktikrat e tilla të financimit dhe pagesat e bëra në bazë të këtyre marrëveshjeve duhet të ndërpriten, dhe në vend të kësaj të insistohet që të gjitha pagesat të bëhen vetëm pas pranimit të shërbimeve dhe të bazuara në fatura dhe në bazë të progresit të marrëveshjeve, dhe jo në formë paradhënie.	Po		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se para se të bëhet shpenzimi, së pari të zbatohen procedurat sipas LPP, përveç shërbimeve që janë të përjashtuara nga moduli i blerjes.	Po		
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e lidhjes së marrëveshjeve për bashkëfinancim do të respektohen kërkesat ligjore (LPP).	Po		
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë do të regjistrohen në pajtim me rregulloren nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë. Projektet të cilat janë në ndërtim e sipër, të regjistrohen si investime në vijim e jo pasuri në përdorim. Po ashtu, komuna të komunikoj në mënyrë efektive me ministritë e linjës që të marrin informata në lidhje me investimet kapitale që bëhen në territorin e tyre. Pasuritë e shitura të komunës në ankand publik të fshihen nga regjistrat e pasurive.		Komuna ka zbatuar pjesërisht këtë rekomandim sa i përket pasurisë kapitale, mirëpo sfide mbetet regjistrimi i pasurisë jo kapitale nën vlerën 1,000€.	

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna ne vitin 2016	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim.	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabimet.		Komuna ka zbatuar pjesërisht këtë rekomandim sa i përket pasurisë kapitale, ndërsa sfidë mbetet pasuria nën 1,000€, përkatësisht mos funksionimi i sistemit e-pasuria.	
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak.	Kryetari duhet të sigurojë se plani i veprimit po zbatohet me kohë dhe në mënyrë efektive për të gjitha rekomandimet e dhëna, dhe me fokus të veçantë tek ato me prioritet të lartë. Progresi në zbatimin e rekomandimeve duhet t'i nënshtrohet rishikimeve sistematike nga Kryetari.			Nuk janë marrë masa.
2.2 Pyetësori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve dhe sigurojë që pasi të jetë hartuar regjistri i rreziqeve, është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhojë këtë proces dhe të raportojë në baza të rregullta mbi rreziqet. Monitorimi i strategjisë zhvillimore duhet të bëhet në baza të vazhdueshme për tu siguruar së objektivat strategjike janë duke u arritur.		Regjistri i rreziqeve është hartuar me 22.02.2018 gjatë kohës sa ne ishim në auditim, ndërsa monitorimi i strategjisë mbetet për tu zbatuar.	
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike.	Kryetari i Komunës duhet hartoj planin e veprimit për monitorimin sistematik të arritjes së objektivave, duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.			Nuk janë marrë masa.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e planeve të veprimit sipas sektorëve dhe të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm dhe në baza mujore t'i monitoroj ato. NJAB, duhet që në fokus të punës të këtë aktivitetet e vitit aktual në mënyrë që të kontribuoj në menaxhim efektiv dhe efikas të kontrollit brendshëm.		Një pjesë e rekomandimeve të dhëna nga NjAB ishin zbatuar dhe KA kishte mbajtur tri takime, mirëpo zbatimi i rekomandimeve duhet të përmirësohet edhe me tej.	
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale bëhet në baza vjetore siç parashihet me ligj.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcoj kontrollet dhe të siguroj se të gjitha pagesat do të bëhen pasi operatorët ekonomik përmbushin të gjitha kushtet e kontratës.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të bëjë pagesa pa fatura dhe raporte të konfirmuara për pranimin e punëve.	Po		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë një proces efektiv të regjistrimit të të gjitha pasurive dhe të funksionalizoj përdorimin e modulit E-pasuria, në pajtim me Rregullën Financiare 02/2013. Gjithashtu, komisionet e inventarizimit duhet të kryejnë inventarizimin e gjithë pasurisë komunale.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet ta analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese për të reduktuar sa më shumë gjendjen e këtyre llogarive.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të trajtoj me kujdes obligimet dhe të merr masat e duhura për të kryer gjitha obligimet brenda afatit kohor.	Po		

Shtojca III: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/SEKTORI PER FINANCA



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Shtimes, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Naim Ismajli

Kryetar Komunes

Data: 21.Maj.2018, Shtime,